

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8093
E premte, 11 korrik 2025
Çmimi 0.50 €

Trumpi lëviz drejt
Ballkanit, zyrtari
amerikan nis misionin
diplomatik në Kosovë,
Serbi dhe Bosnjë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

RREZIKU I NJË SITUATE TË PAPRECEDENTË NË KOSOVË PAS 26 KORRIKUT

- Barra e përgjegjësisë duhet të kalojë mbi presidenten
Osmani, e cila ka detyrë kushtetuese ta garantojë
funksionimin demokratik të institucioneve



Heqja e mandateve të deputetëve, një opsion i përmendur në rast të moskonstituimit të Kuvendit deri më 26 korrik, nuk është duke u konsideruar e realizueshme.

Ekspertët juridikë dhe njohësit e çështjeve politike kanë paralajmëruar se, nëse ky afat shkelet, vendi do të përballet me një krizë politike dhe juridike të panjohur më parë. Ata kanë

thënë se barra e përgjegjësisë duhet të kalojë tani mbi presidenten, Vjosa Osmani, e cila e ka detyrë kushtetuese të garantojë funksionimin demokratik të institucioneve

MILIONA EURO TË
PEZULLUARA E NDIKIM
NË INTEGRIM: SI
NDIKUAN MASAT E
BE-SË NDAJ KOSOVËS
QË S'U HOQËN KURRË?

F. 7



KRYETARJA E
KUVENDIT TË
SHQIPËRISË: BOTA
SERBE ËSHTË E
RREZIKSHME
PËR RAJONIN

F. 3



KOMPANIA E VËLLAIT TË SHEFIT
TË KABINETIT TË KURTIT MERR
LICENCË NGA ZRRE-JA PËR TREGTI
ME ENERGJI

F. 8

ATK-ja MBLEDH MBI 500 MILIONË
EURO TATIME PËR GJASHTË MUJ

F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

SPORT

KOSOVA NGRIHET PËR DY POZITA NË
RENDITJEN E FIFA-S

F. 10



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

Shefja e BE-së i mbijeton votëbesimit

BRUKSEL, 10 KORRIK - Një votëbesim kundër shesheve të Bashkimit Evropian (BE), Ursula von der Leyen, ka dështuar që ta sigurojë shumicën e votave të nevojshme për të ecur përpara. Vetëm 175 anëtarë të Parlamentit Evropian (PE) e kanë përkrahur mocionin, derisa 360 kanë votuar kundër dhe 18 kanë abstenuar. Nacionalisti rumun Gheorghe Piperea ka qenë i ashpër në fjalimin e tij në Parlament para votimit. “Vendimarrja është bërë e errët dhe diskrecionare dhe ngjall frikën e abuzimit dhe korrupsionit. Kostoja e burokracisë obsesive e Bashkimit Evropian, siç është



(trajtimi) i ndryshimeve klimatike, ka qenë e madhe”, ka thënë ai. Ky votim, i pari i këtij lloji në

Parlamentin Evropian në mbi një dekadë, është organizuar nga ligjvënës të ekstremit të djathtë.

Mocioni përbëhet nga një mori dyshimesh kundër von der Leyenit, përfshirë mesazhet private me shefin e fabrikës “Pfizer” që ka prodhuar vaksina kundër koronavirusit, për keqpërdorim të fondeve të BE-së dhe për ndërhyrje në zgjedhjet në Gjermani dhe Rumani. Kryeministri hungarez Viktor Orban ka thënë paraprakisht përmes një postimi në “Facebook” se votimi “do të jetë moment i së vërtetës, në njërin anë do të jetë elita imperialiste e Brukselit, në tjetrën patriotët. Është thelbësore të bëhet një zgjidhje”. “Zonja presidente, thelbi i

udhëheqës tuaj është përgjegjësia. Është koha të largoheni!”, ka thënë ai. Shefja e BE-së ka pasur shpesh mospajtime me Orbanin për shkak të veprimeve të tij në Budapest që kanë dëmtuar demokracinë. Prandaj, Komisioni Evropian ia ka ngrirë qasjen në miliarda euro në fonde të BE-së. Ky votim ka hapur rrugën për shumë kritika ndaj von der Leyenit, e cila ka qenë në krye të nismës së BE-së për të gjetur vaksina për gati 450 milionë banorë gjatë pandemisë, por edhe për Partinë e saj Popullore Evropiane, e cila përbën grupin më të madh politik në parlament.

Rutte: Rusia do ta shënjestrojë Evropën nëse Kina sulmon Tajvanin

BERLIN, 10 KORRIK - Shefi i NATO-s, Mark Rutte, ka paralajmëruar se Kina dhe Rusia paraqesin kërcënime në rritje për aleancën transatlantike, duke konfirmuar se NATO po përgatitet për një sulm të mundshëm rus në shkallë të plotë në territorin e aleancës në vitet e ardhshme. “Xi Jinping, presidenti i Kinës, përpara se të sulmojë Tajvanin, së pari do të telefonojë në Moskë për t’i kërkuar (presidentit rus) Putinin të na mbajë të zënë në këtë pjesë të Evropës”, u ka thënë Rutte gazetarëve në një konferencë për medie me kancelarin gjerman Friedrich Merz në

Berlin. Ai ka thënë se Kina është duke i ndërtuar me shpejtësi forcat e saj të armatosura. “Ata tani kanë më shumë anije se sa ShBA-ja. Ata do të kenë edhe 100 anije deri në vitin 2030. Ata tani kanë 1000 koka bërthamore. Kjo nuk është për të organizuar parada në Pekin. Kjo është me të vërtetë për ta përdorur, për ta shfrytëzuar këtë”, ka thënë ai, duke parashikuar se Kina do të përpiqet të marrë disi kontrollin e Tajvanit. “Supozimi ynë është, bazuar në shumë diskutime që kemi pasur, dhe sigurisht, ajo që dimë nga burimet tona është se rreziku është gjithnjë e më shumë i



pranishëm”, ka thënë Rutte. Më tutje, Rutte ka argumentuar se kërcënimet e sigurisë ndaj NATO-s nga Indo-Paqësori janë rritur ndjeshëm vitet e fundit. Ai ka përmendur pjesëmarrjen aktive të Koresë së Veriut në luftën e Ukrainës duke mbështetur Rusinë, furnizimin e Kinës me mallra me përdorim të dyfishtë për Rusinë dhe ndarjen e teknologjisë së

dronëve nga Irani me forcat ruse. Rutte ka pohuar se Rusia nuk do të ndalet në Ukrainë dhe ka të ngjarë të nisë një sulm në territorin e NATO-s brenda shtatë viteve të ardhshme. “Disa nga gjeneralët tuaj gjermanë, shumë të lartë, kanë parashikuar se tre, pesë, shtatë vjet nga tani, Rusia mund të jetë në gjendje të ndërmarrë një sulm të plotë në territorin e NATO-s. Tre vjet është sot, pesë vjet është java tjetër, shtatë vjet është muaji tjetër”, ka paralajmëruar ai, duke shtuar se aleatët evropianë duhet të rrisin shpenzimet e tyre të mbrojtjes për të forcuar parandalimin.

Rutte ka theksuar se aleatët e NATO-s vendosën të rrisin objektivat e tyre të shpenzimeve të mbrojtjes në samitin e muajit të kaluar jo për të qetësuar presidentin e ShBA-së, Donald Trump, por sepse e njohin kërcënimin në rritje. “Ne nuk po bëjmë shpenzimet bazë prej 5,0 dhe 3,5 për qind për ta bërë të lumtur një person. Ne e bëjmë këtë sepse e dimë se kërcënimin është i pranishëm. Një kërcënim kundër ShBA-së, një kërcënim kundër Kanadasë, një kërcënim kundër aleatëve evropianë. Dhe kjo është arsyeja pse duhet të shpenzojmë më shumë për mbrojtje”, ka thënë shefi i NATO-s.

Macroni në Londër: Franca dhe Britania mund ta shpëtojnë Evropën

LONDËR, 10 KORRIK - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, ka kërkuar nga Britania e Madhe të qëndrojë pranë fqinjëve të saj, pavarësisht daljes nga Bashkimi Evropian (BE), duke deklaruar se të dy vendet do ta “shpëtojnë Evropën” përmes mbrojtjes së demokracisë, ligjit dhe rendit ndërkombëtar në një botë të rrezikshme. Gjatë një vizite shtetërore që ka kombinuar ceremonitë mbretërore me bisedime mbi çështje si Ukraina dhe migracioni, Macroni ka thënë se Evropa duhet të forcojë ekonominë dhe mbrojtjen, si dhe të zvogëlojë varësinë nga Shtetet e Bashkuara dhe Kina. Udhëtimi tregoi të Macronit, i bërë me ftesë të Mbretit Charles, është vizita e parë shtetërore në

Britani nga një udhëheqës i Bashkimit Evropian që nga Brexit-i. Kjo vizitë simbolizon dëshirën e qeverisë britanike për të përmirësuar marrëdhëniet me bllokun evropian pas daljes nga BE-ja në vitin 2020. Duke iu drejtuar anëtarëve të të dy dhomave të Parlamentit britanik, Macroni ka thënë se Franca dhe Britania e Madhe përfaqësojnë “një rend botëror të bazuar në ligj, drejtësi dhe respekt për integritetin territorial - një rend që sot po sfidohet çdo ditë”. Ai ka theksuar se “Britania e Madhe dhe Franca duhet t’i tregojnë botës se aleanca jonë mund të bëjë ndryshimin”, duke shtuar se “ne do ta shpëtojmë Evropën me shembullin dhe solidaritetin

tonë”. Sipas tij, edhe pse Britania është larguar nga BE-ja, “nuk mund të qëndrojmë mënjane”, pasi çështjet e mbrojtjes, sigurisë, konkurrencës dhe demokracisë janë të ndërthurura në të gjithë kontinentin evropian. Macroni ka nënvizuar se Britania dhe Franca kanë përgjegjësi për të trajtuar migracionin e parregullt me “humanizëm, solidaritet dhe vendosmëri”. Ai ka thënë se një zgjidhje efektive mund të arrihet vetëm përmes bashkëpunimit me vendet e origjinës dhe tranzitit të emigrantëve. Edhe pse Britania e Madhe pranon më pak azilkërkues krahasuar me disa vende të



Mesdheut, mijëra emigrantë përdorin Francën veriore si pikënisje për të kaluar në Britani, shpesh duke u fshehur në automjete ose duke kaluar Kanalin Anglez me varka të vogla, një nga rrugët më të ngarkuara detare në botë. Britania ka arritur disa

marrëveshje me Francën për të rritur patrullimet në plazhe dhe për të ndarë informacion, me qëllim goditjen e rrjeteve të kontrabandës. Megjithatë, këto masa kanë pasur ndikim të kufizuar. Macroni dhe kryeministri britanik, Keir Starmer kanë bashkëpunuar ngushtë për të siguruar mbështetje për Ukrainën, edhe pse kanë qëndrime të ndryshme ndaj presidentit amerikan, Donald Trump. Britania dhe Franca po udhëheqin përpjekjet për të krijuar një forcë ndërkombëtare paqeruajtëse për Ukrainën, me synim mbështetjen e një armëpushimi të mundshëm me trupa dhe pajisje evropiane dhe garanci sigurie nga ShBA-ja.

“MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-së DO T’I ZBEHË PROVAT E ZPS-së”

PRISHTINË, 10 KORRIK - Procesi gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së në Hagë është duke shkuar drejt fundit. Avokati i akredituar pranë Gjykatës Speciale, Skënder Musa, ka deklaruar se procesi gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit po hyn në fazën përfundimtare.

Ai ka thënë se prokuroria është në fund të paraqitjes së saj dhe beson se brenda këtij viti do të përfundojë procesi gjyqësor ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit. “Ende nuk ka përfunduar faza e mbrojtjes ku do të merren në pyetje edhe dëshmitarët. Paraprakisht do të vendoset edhe kërkesa e mbrojtjes për urdhër në aktakuzë. Procesi gjyqësor është në fazën finale dhe nuk ka mbetur edhe shumë kohë që të përfundojë. Besoj brenda këtij viti do të ketë një përfundim të procesit gjyqësor”, ka deklaruar Musa për “FrontOnline”.

Sipas Musës, ende do të zhvillohen dëgjime të dëshmitarëve të mbrojtjes dhe pritet vendimi për kërkesën e mbrojtjes lidhur me urdhrin në aktakuzë. Ai ka thënë se nuk mund të bëhen parashikime të sakta për vendimin

përfundimtar. “Dëgjoen edhe dëshmitarët e mbrojtjes dhe pastaj bëhet shpallja e aktgjykimit deri në fillim të vitit të ardhshëm besoj. Procesi është në fazë përfundimtare. Nuk mund ta parashikojmë asnjë proces gjyqësor. Bazuar në këtë që e kemi parë ka shanse të mira që të merret aktgjykim lirues, por nuk mund të paragjykoen vendimet e gjykatës”, ka thënë Musa.

Ndërsa avokatja e akredituar pranë Gjykatës Speciale në Hagë, Fehmije Bytyqi-Gashi, ka thënë se prokuroria tashmë i ka përfunduar paraqitjet e saj në procesin gjyqësor ndaj liderëve të UÇK-së. Ajo ka thënë se tashmë është radha e mbrojtjes për të paraqitur dëshmitarët dhe provat e tyre, siç parashihet me ligj. “Prokuroria i ka kryer të gjitha provat e tyre. Tash është rendi i Thaçit dhe Veselit me i paraqit provat e veta. Kështu parashihet. Sipas ligjit deri tash prokuroria ka përparësi në krahasim me avokatët. Tash avokatët e këtyre do t’i marrin dëshmitarët e vet për t’i demantuar ato. Dhe pas tyre jepet fjala përfundimtare dhe nxirret aktgjykim”, ka deklaruar ajo.

Avokatja ka thënë se mbrojtja



synon të zbehë fuqinë e provave të prokurorisë dhe shpreson që procesi të përfundojë para vitit 2026. “Ne si mbrojtje e liderëve tanë do t’i zbehim ato deklarata të cilat nuk do të jenë aq prova të forta. Sa zgjatë nuk e dimë, por shpresoj që të përfundoj para vitit 2026”, ka thënë Bytyqi-Gashi.

Liderët e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, kanë pasur kohë ta dorëzojnë mocionin për rrëzimin e akuzave deri më 12 qershor.

Prokuroria e Specializuar e Hagës ka pasur kohë të përgjigjet në mocionin e mbrojtjes të hënën më 7 korrik. Gjyqtarët pritet ta marrin vendimin për

këtë mocion në javën që fillon më 14 korrik. Varësisht se cili do të jetë vendimi lidhur me mocionin, pritet të vazhdojë edhe procesi gjyqësor. Megjithatë, deri atëherë janë caktuar edhe disa data të tjera me rëndësi.

Një konferencë për ecurinë e çështjes do të mbahet të martën, më 22 korrik, në orën 14:00. Nëse mocioni rrëzohet, avokati i viktimave urdhërohet të përgatitet të ftojë dëshmitarët e tij më 16 korrik. Mbrojtja e krerëve të UÇK-së duhet ta njoftojë Gjykatën Speciale deri më 16 korrik nëse synon të dorëzojë provat e veta. Mbrojtja duhet t’i dorëzojë provat dhe listat e dëshmitarëve

deri më 21 korrik.

Gjyqtarët kanë vendosur që konferencën statusore për rastin e mbrojtjes ta shtyjnë deri më 19 gusht. Rasti i mbrojtjes pritet të fillojë menjëherë pas 18 gushtit, varësisht se si përcaktohen afatet. Konferenca përgatitore për rastin e mbrojtjes mbahet më 22 gusht. 20 deri në 25 dëshmitarë pritet t’i ketë mbrojtja e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare në Gjykatën Speciale të Hagës. Prej tyre, rreth 15 mund të ftohen për të dëshmuar “live” në gjykatë. Në një parashtrim të cilin e ka parë gazeta “Nacionale”, thuhet se mbrojtja e Thaçit mund të thërrasë deri në 12 dëshmitarë që do të dëshmojnë në Gjykatë, por që edhe ky numër mund të reduktohet. Kurse mbrojtja e Jakup Krasniqit do të ketë 10 dëshmitarë, prej të cilëve maksimalisht pesë do të dëshmojnë në Gjykatën Speciale. Aktualisht, mbrojtja e Veselit dhe Selimit nuk kanë planifikuar të ftojnë dëshmitarë. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi gjenden në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në prill të vitit 2023.

HIDHET POSHTË ANKESA E SALIH MUSTAFËS SE DËNIMI ME 15 VJET BURGIM NDAJ TIJ SHKEL KUSHTETUTËN

HAGË, 10 KORRIK - Gjykata Kushtetuese e Gjykatës Speciale ka hedhur poshtë ankesën e fundit të Salih Mustafës, i cili ka pretenduar se dënimi me 15 vjet burgim ndaj tij shkel Kushtetutën e Kosovës. Sipas Mustafës, dënimi i tij prej 15 vjet për vrasje të paligjshme si krim lufte, shkel nenin 33 (3) të Kushtetutës së Kosovës dhe se ky dënim ishte joproporcional në raport me veprën penale. Më 9 korrik 2025 Gjykata Speciale ka konstatuar se kërkesa ishte e papranueshme, raporton “Betimi për Drejtësi”. Në vendim është konstatuar se Mustafa nuk ka arritur të provojë se dënimi i shqiptuar



ndaj tij përbënte shkelje të të drejtave themelore. Në ankesën e tij të dorëzuar më 24 prill 2025, Mustafa kishte

thënë se i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara sipas nenit 33 (3) të Kushtetutës së Kosovës e cila

përcakton se shkalla e dënimit duhet të jetë proporcionale me veprën penale.

Mustafa kishte pretenduar se Apeli kur e pati shpallur dënimin e ri e ka shkelur këtë dispozitë e cila ka për qëllim ta mbrojë të akuzuarin dhe se Supremja më pas nuk e ka korrigjuar këtë gabim, por e kishte refuzuar kundërshtimin e mbrojtjes.

Aktgjykimi ndaj Mustafës në shkallë të parë ishte shpallur më 16 dhjetor 2022, me të cilin Mustafa është dënuar me 26 vjet burgim. Ndërsa më 6 prill 2023, Salih Mustafa ishte urdhëruar që të paguajë 207 mijë euro për zhdëmtim të viktimave. Më pas ai kishte

paraqitur në Panelin e Gjykatës së Apelit 51 pika kundër vendimit dënues të Themelores së Speciales ndaj tij. Kurse Apeli i Speciales më 14 dhjetor 2023 ka shpallur aktgjykim ndaj Salih Mustafës, me të cilin e kishte dënuar me dënim unik prej 22 vjetësh burgim për krime lufte. Më 10 shtator 2024 Gjykata e Apelit në Hagë ka marrë vendim ta ndryshojë dënimin nga 22 në 15 vjet burgim për Salih Mustafën pasi Supremja e kishte kthyer sërish çështjen te kjo shkallë. Sërish, Cali ishte ankuar në Supreme për vendimin e dytë të Apelit, por shkalla e tretë e pati lënë në fuqi këtë dënim ndaj tij.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë: Bota serbe është e rrezikshme për rajonin

TIRANË, 10 KORRIK - Shqipëria ka ftuar Bullgarinë të bashkohet me aleancën ushtarake trepalëshe e cila përfshin edhe Kroacinë dhe Kosovën. Kjo iniciativë nuk bie ndesh me parimet e NATO-s.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Elisa Spiropali, në një intervistë për agjencinë e lajmeve “BGNES” në Bullgari, ka folur edhe nëse iniciativa “Bota Serbe” përbën një problem sigurie për Shqipërinë

dhe Ballkanin. “Lidhur me iniciativën ‘Bota Serbe’ të presidentit Aleksandër Vuçiq, dua të deklaroj se çdo hap që shikon prapa, mbështetet në retorikën e së kaluarës që mund të jetë shqetësuese dhe tingëllon shqetësuese si për Kosovën ashtu edhe për Shqipërinë. Është në interesin tonë të arrijmë përparim në negociatat dypalëshe për njohje reciproke midis Serbisë dhe Kosovës, si dhe përparim

dhe hapje të rrugës që Kosova të ecë përpara, të ruajë paqen në Ballkan dhe të sigurojë stabilitetin në rajon dhe më gjerë”, ka thënë Spiropali. Ajo ka deklaruar se Tirana dëshiron ta ndihmojë Prishtinën të bëhet anëtare e NATO-s dhe të integrohet me shpejt në aleancë, si dhe në disa organizata të tjera ndërkombëtare.

Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë ka folur edhe për



aleancën trepalëshe të lidhur së fundmi midis Shqipërisë, Kroacisë dhe Kosovës. Kur është pyetur nga “BGNES” për rëndësinë e saj për sigurinë në rajon, Elisa Spiropali ka vënë në

dukje se NATO si organizatë parashikon në statutin e saj ekzistencën e iniciativave rajonale në formate të tilla si ai që u zgjodh në këtë rast. “Kjo nuk është kundër dikujt, por për diçka”, ka thënë ajo. Elisa Spiropali ka deklaruar se kjo iniciativë trepalëshe nuk është pikërisht trepalëshe. “Ne e ftojmë Bullgarinë të bashkohet, si dhe çdo vend tjetër që ndan të njëjtat vlera dhe shikon në të njëjtin drejtim”, ka thënë Spiropali.



RREZIKU I NJË SITUATE TË PAPRECEDENTË NË KOSOVË PAS 26 KORRIKUT

- Barra e përgjegjësisë duhet të kalojë mbi presidenten Osmani, e cila ka detyrë kushtetuese ta garantojë funksionimin demokratik të institucioneve

Heqja e mandateve të deputetëve, një opSION i përmendur në rast të moskonstituimit të Kuvendit deri më 26 korrik, nuk është duke u konsideruar e realizueshme. Ekspertët juridikë dhe njohësit e çështjeve politike kanë paralajmëruar se, nëse ky afat shkelet, vendi do të përballet me një krizë politike dhe juridike të panjohur më parë. Ata kanë thënë se barra e përgjegjësisë duhet të kalojë tani mbi presidenten, Vjosa Osmani, e cila e ka detyrë kushtetuese të garantojë funksionimin demokratik të institucioneve

PRISHTINË, 10 KORRIK - Situata në Kosovë mbetet e bllokuar, ndërsa heqja e mandateve të deputetëve - një opSION i përmendur në rast të moskonstituimit të Kuvendit deri më 26 korrik - nuk konsiderohet e realizueshme. Ekspertët kanë paralajmëruar se, nëse ky afat shkelet, vendi do të përballet me një krizë politike dhe juridike të panjohur më parë. Askush nuk ka përgjigje të qartë se çfarë do të ndodhë në Kosovë pas 26 korrikut - datë kur skadon afati prej 30 ditësh që Gjykata Kushtetuese ua ka dhënë deputetëve të zgjedhur për ta konstituuar Kuvendin. Deri tani përpjekjet për formimin e këtij institucioni ligjvënës kanë dështuar 44 herë. Partitë politike vazhdojnë ta fajësojnë njëra-tjetrën për ngërçin dhe të mos lëvizin nga qëndrimet e tyre. Në këtë atmosferë bllokade,

ish-gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Gjyljeta Mushkolaj, ka thënë se barra e përgjegjësisë duhet të kalojë tani mbi presidenten e vendit, Vjosa Osmani, e cila e ka detyrë kushtetuese ta garantojë funksionimin demokratik të institucioneve. Sipas saj, e para e shtetit duhet t'i shtojë përpjekjet për arritjen e një konsensusi mes partive politike dhe, nëse kjo dështon, të kërkojë interpretim shtesë nga Gjykata Kushtetuese për t'i qartësuar hapat e ardhshëm. "Gjykata Kushtetuese duhet të jetë më e prerë rreth afatit që e ka përcaktuar dhe pasojave që vijnë pas këtij afati. Roli i Gjykatës Kushtetuese nuk ka përfunduar ende", ka thënë Mushkolaj për "Radion Evropa e Lirë". Javën e kaluar presidentja Osmani kishte pritur për dy ditë me radhë përfaqësuesit e partive politike në përpjekje

për ta zhblokuar situatën. Pas takimeve, ajo ishte shprehur qartë se konstituimi i Kuvendit brenda afatit 30-ditor të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese është "detyrim e jo opSION" dhe u kishte bërë thirrje partive që sa më shpejt të gjejnë zgjidhje. Këshilltari i saj për medie i Osmanit, Bekim Kupina, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se presidentja është duke i shqyrtuar mundësitë ligjore për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për sqarim të aktgjyimit, "në mënyrë që të qartësohen pasojat juridike, në rast se Kuvendi nuk konstituohet brenda afatit të përcaktuar nga ajo". Ndërsa në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD) kanë thënë se konsensusi është e vetmja rrugë për të tejkaluar bllokadën dhe për të konstituuar Kuvendin deri më 26 korrik. Nëse kjo nuk ndodh, Kosova do të përballet me një situatë të panjohur deri më tash, ka thënë Naim Jakaj nga ky institut. "Kosova do të hyjë në një situatë të re juridike dhe politike, që nuk e ka përjetuar më herët. Pasojat e saj do t'i ndiejmë në muajt e ardhshëm, në rast se Kuvendi nuk konstituohet deri më 26 korrik", ka thënë Jakaj për "REL"-in.

A mund t'u merret mandati deputetëve?

As Lëvizja Vetëvendosje, që ka dalë e para në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, nuk ka një përgjigje të qartë për zhvillimet që mund të pasojnë nëse Kuvendi nuk konstituohet deri më 26 korrik. Më 9 korrik, në përgjigje të pyetjes së gazetarëve për këtë çështje, deputetja e Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë shkurt: "E paparashikuar". Ditë më parë, ajo kishte përmendur mundësinë që të gjithë deputetët e Kuvendit të humbin mandatin, nëse nuk e konstituojnë institucionin brenda afatit 30-ditor, të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese. "...janë 120 deputetë të legjislaturës së 9-të, që mund t'iu merret mandati, dhe të vazhdohet pastaj me deputetët që janë në listat e të gjitha partive politike", kishte thënë Kusari-Lila. Por, Mushkolaj ka shpjegon se mandatin e deputetëve të zgjedhur në mënyrë demokratike nuk mund ta marrë askush. "Populli ua ka dhënë këtë mandat dhe populli ua merr mandatin. Vetëm nëse shkojmë në zgjedhje. Por, përsëri, duhet të konstituohet Kuvendi", ka thënë profesresha në

Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Jakaj, gjithashtu, ka thënë se nuk e sheh të mundshme heqjen e mandatit të deputetëve. Ai ka theksuar se Kushtetuta e Kosovës, në nenin 70, përcakton qartë arsyet për përfundimin ose pavlefshmërinë e mandatit të deputetit. Ato përfshijnë: mosbetimin, dorëheqjen, emërimin në qeveri, përfundimin e mandatit të kuvendit, mungesën prej gjashtë muajsh në seanca, dënimin me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vite burgim, ose vdekjen e deputetit. "Në asnjë nga pikat e aktgjyimit, Gjykata Kushtetuese nuk i ka saktësuar pasojat kolektive apo individuale për deputetët, në rast të moskonstituimit brenda afatit prej 30 ditësh", ka thënë Jakaj.

Muhaxhiri: Nuk ka precedent për marrjen e mandateve

Edhe Artan Muhaxhiri, sociolog dhe njohës i politikës në Kosovë, thotë se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk parashikon marrjen e mandateve nga deputetët, në rast të

TRUMPI LËVIZ DREJT BALLKANIT, ZYRTARI AMERIKAN NIS MISIONIN DIPLOMATIK NË KOSOVË, SERBI DHE BOSNJË

PRISHTINË, 10 KORRIK - Administrata e presidentit amerikan Donald Trump ka rikthyer vëmendjen e saj diplomatike në Ballkan, duke dërguar një zyrtar të lartë për një vizitë zyrtare në tri shtete kyçe të rajonit.

Zyrtari i lartë i Departamentit Amerikan të Shtetit për Çështje Evropiane, Brendan Hanrahan, do të nisë një vizitë në Kosovë dhe dy vende të tjera të Ballkanit, Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë. “Pres me padurim përforcimin e lidhjeve në mes të Shteteve të Bashkuara dhe shteteve në rajon”, ka thënë ai në një postim në platformën “X”.

Hollësi të tjera për vizitën nuk janë dhënë. Hanrahan është takuar një ditë më parë me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, në zyrën e Departamentit të Shtetit në Uashington. Përmes një postimi në “Facebook”, ajo ka thënë se bashkë me diplomatën amerikanë kanë diskutuar për “thelimin e partneritetit strategjik midis Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara”. “Kosova është e gatshme ta avancojë bashkëpunimin me SHBA-të në fusha kyç si mbrojtja, ekonomia, si dhe investimet strategjike me interes të ndërsjellë”, ka thënë Osmani. Sa i përket vizitës në Bosnjë-Hercegovinë, Hanrahan e ka përmendur Dejtonin - marrëveshjen që i ka dhënë



fund luftës në Bosnjë më 1995, dhe rëndësinë e përvjetorit, që duket se është referencë për Srebrenicën.

Më 11 korrik të vitit 1995 janë vrarë më shumë se 8300 boshnjakë nga ushtria e Republikës Sërpska - entitetit serb të Bosnjës. Masakra e

Srebrenicës është cilësuar si më e rënda në Evropë që prej Luftës së Dytë Botërore dhe njihet si gjenocid.

Në maj të vitit të kaluar, Kombet e Bashkuara e kanë miratuar një rezolutë, e cila njeh 11 korrikun si Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit

të Gjenocidit në Srebrenicë. Deri më tani mbi 6 650 viktima të gjenocidit janë varrosur në Qendrën Përkujtimore Potoçari. Më shumë se 1 000 persona të zhdukur janë ende në kërkim. Gjykata të ndryshme kanë dënuar deri tash më shumë se 50 persona,

me më shumë se 700 vjet burg, për gjenocid dhe krime të tjera në Srebrenicë.

Ish-udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, Radovan Karaxhiq, është i dënuar me burgim të përjetshëm, ashtu si edhe ish-udhëheqësi ushtarak në Bosnjë, Ratko Mlladiq.

moskonstituimit të Kuvendit brenda afatit. Për më tepër, thekson ai, në Kosovën e pasluftës nuk ka ndonjë precedent të ngjashëm. Ai ka thënë se një hap i tillë do të kërkonte një vendim të ri të Gjykatës dhe ndryshime në mënyrën e zëvendësimit të deputetëve, por, prapëseprapë, nuk do të garantonte tejkalimin e bllokadës politike që po e pengon formimin e institucioneve. “E para, ata deputetë që do të vinin, do të kishin më pak legjitimitet dhe pothuajse të gjithë do të ishin anonimë, pa përvojë politike. Vetë fakti që nuk janë

zgjedhur, dëshmon se nuk kanë arritur sukses as në garën përbrenda partive të tyre”, ka thënë Muhaxhiri për “Radion Evropa e Lirë”. Ai ka theksuar se personat që do t’i zëvendësonin deputetët aktualë, do të vepronin nën udhëzimet e liderëve të partive të tyre, ndaj sjellja e tyre në procesin e konstituimit të Kuvendit do të ishte e njëjtë me atë të deputetëve aktualë. “Do të ktheheshim në pikën ku jemi tash, por me një humbje të kohës dhe me një dëmtim të perspektivës së Kosovës dhe imazhit institucional në përgjithësi”, ka theksuar Muhaxhiri.

Ku ka mbetur seanca konstituive e Kuvendit të Kosovës?

Deri më tani deputetët kanë përfunduar vetëm dy pika të agjendës: raportin e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e mandateve dhe betimin e deputetëve. Procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryetarit të Kuvendit. Kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, nuk ka arritur t’i sigurojë 61 votat e nevojshme në disa runde votimi për t’u zgjedhur në këtë post.

Dy parti parlamentare, PDK-ja dhe AAK-ja, e shohin Haxhiun si figurë përçarëse dhe kërkojnë nga Lëvizja Vetëvendosje të propozojë një emër tjetër për kryeparlamentar. LDK-ja ka thënë se nuk do të mbështesë asnjë kandidat të Vetëvendosjes për këtë pozitë. E, Vetëvendosje këmbëngul tani që votimi për Haxhiun të bëhet në mënyrë të fshehtë, duke premtuar se nëse ajo nuk i merr 61 vota, do të propozojë një kandidat tjetër. Por, kjo formë votimi kundërshtohet nga partitë e tjera, duke e futur situatën në një rreth vicioz. Gjykata

Kushtetuese ka nxjerr aktgjykimin për konstituimin e Kuvendit me afat 30 ditësh më 26 qershor, pas 37 tentativave të dështuara në këtë proces. Megjithatë, ekspertët kushtetues dhe partitë politike e kanë kuptuar dhe interpretuar këtë vendim në mënyra të ndryshme. Muhaxhiri ka thënë se për të tejkaluar bllokadën në Kuvend, është e nevojshme që Gjykata Kushtetuese të dalë me një vendim më të qartë dhe më të drejtpërdrejtë. Sot (e premte) në orën 11:00 do të vazhdojë seanca konstituive, e cila ka filluar më 15 prill të këtij viti.

Haradinaj dhe ambasadori gjerman diskutojnë për zgjidhjen e bllokadës në Kuvend

PRISHTINË, 10 KORRIK - Lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e Gjermanisë në vendin tonë, Jorn Rohde. Haradinaj ka bërë me dije se me ambasadorin gjerman ka biseduar për tejkalimin e bllokadës në Kuvendin e Kosovës. “Sot pata kënaqësinë të mirëpres në

zyrat e Aleancës ambasadorin gjerman në Kosovë, z. Jorn Rohde. Gjatë takimit diskutuam për zhvillimet aktuale në vend, me theks të veçantë situatën e krijuar pas zgjedhjeve parlamentare. Rikonfirmova përkushtimin tim dhe të Aleancës për të ndihmuar në gjetjen e një zgjidhjeje për tejkalimin e bllokadës tashmë disa

mujore, me qëllim të konstituimit të Kuvendit dhe formimit të institucioneve të reja. I jam mirënjohës ambasadorit Rohde për angazhimin e tij të vazhdueshëm dhe për përkushtimin e palëkundur të Gjermanisë ndaj Kosovës dhe rrugëtimit të saj euroatlantik”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



E DREJTA PËR JETË DHE E DREJTA PËR DREJTËSI

Reagim i KMDLNj-së

Përfundimi tragjik i Agon Zejnullahut në Lipjan, me të drejtë shkaktoi pakënaqësi dhe indinjatë prandaj pati reagime të shumta. Kërkohej përgjegjësi për policët e implikuar në këtë rast të rëndë sikur që kërkohej përgjegjësi politike dhe institucionale të atyre që realisht edhe kanë përgjegjësi. IPK-ja fillimisht suspendoi 5 policë e që pas reagimit të opinionit iu caktua ndalimi policor prej 48 orëve që pastaj, me vendim të gjykatës iu caktua masa e paraburgimit 5 policëve. Si përgjigje ndaj përgjegjësisë institucionale, vetëm komandanti i stacionit policor në Lipjan dha dorëheqje apo u shkarkua. Dhe këtu, deri më tani mori fund përgjegjësia politike apo institucionale. Reagimi i opinionit dhe medieve ishte kryesisht kundër 5 policëve e që lë për të dyshuar se edhe vendimi për caktimin e masës së paraburgimit është si rezultat i reagimeve dhe presionit të madh. Nëse nisemi nga parimi se përgjegjësia është personale

atëherë, në bazë të incizimeve duket qartë se si shkuan gjërat dhe se kush ka përgjegjësi konkrete për përfundimin tragjik të Agon Zejnullahut. Një rast jashtëzakonisht i rëndë ndodhi në stacionin policor në Therandë ku një i privuar nga liria, në rrethana të pasqaruara për publikun bëri vetëvrasje pas së cilës u suspenduan disa zyrtarë policorë. Shkelje flagrante e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria ndodhi edhe në Klinë kur një qytetar i prangosur u keqtrajtuar nga policë ndonëse ishte neutralizuar dhe nuk përbënte rrezik për askënd. Për të tri rastet KMDLNj-ja ka reaguar duke kërkuar hetime si parashihen me ligj dhe, duke kërkuar të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë, si e drejtë e njeriut që rregullohet me ligj. Duhet të vlerësohet shumë puna e mediave për bërjen publike të këtyre rasteve mirëpo, në të njëjtën kohë KMDLNj-ja e kundërshton përpjekjet e të gjithë atyre që duan të përfitojnë politikisht, për promovine personale, publicitet apo qëllime tjera. Përgjegjësia ligjore përcaktohet pas përfundimit të

hetimeve dhe një procesi të drejtë gjyqësor, me një vendim të formës së prerë të gjykatës përkatëse andaj çdo ndërhyrje paragjyquese vetëm sa i pengon hetimet dhe vendimmarrjen gjyqësore të mbështetur në prova. KMDLNj-ja ka një histori të gjatë bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe nuk pajtohet me përgjithësimin e përgjegjësisë kur përgjegjësia është individuale. Policia e Kosovës, përkundër kushteve të vështira, ka bërë punë shumë të mira prandaj nuk mund të pranohet cilësimi se nga heronj janë bërë dhunues brutal. Thjesht, kjo nuk është e vërtetë dhe nuk përkon me realitetin. Ndërkaq, sa i përket përgjegjësisë politike dhe institucionale, për rastet e fundit përgjegjësia politike është 100 për qind te Ministria për Punë të Brendshme ndërkaq përgjegjësia institucionale është te zinxhiri komandues dhe mekanizmi mbikëqyrës. KMDLNj-ja e informon opinionin se çdo shkelje që bëhet në ndalimin 48 orësh policor, hapësira publike dhe jopublike, i adresohet Policisë së Kosovës që është nën



përgjegjësi të Ministrisë për Punë të Brendshme ndërsa shkeljet që bëhen në qendrat e paraburgimit dhe në qendrat korrektuese, adresa e përgjegjësisë është Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe e Ministrisë së Drejtësisë. KMDLNj-ja inkurajon Policinë e Kosovës të mos i nënshtrohet urdhrave të politikës përkatësisht MPB-së që e cenojnë profesionalizmin, pavarësinë operacionale dhe integritetin e Policisë së Kosovës. KMDLNj-ja, gjithashtu inkurajon gjyqësorin

të mos marrë asnjë vendim nën presion të askujt për faktin se do të identifikohet si shkelës i të drejtave të njeriut duke mos garantuar hetime të pavarura dhe një proces gjyqësor të drejtë dhe të pandikuar nga politika apo grupet e interesit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, në shumë raste ka kërkuar anulimin e vendimeve gjyqësore që janë marrë nën presion të publikut. Në Kosovë kjo thauja po shndërrohet në standard, rregull.

MIRATOHET DORËHEQJA E KOMANDANTIT TË POLICISË NË LIPJAN PAS VDEKJES SË 27-VJEÇARIT

Prishtinë, 10 korrik - Drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka bërë me dije se e ka miratuar kërkesën e komandantit të Policisë për rajonin e Lipjanit, Argjend Gashi, për të dhënë dorëheqje nga pozita, pas rastit të raportuar më herët gjatë javës në këtë komunë, në të cilin ka vdekur 27-vjeçari Agon Zejnullahu. “Ka bërë kërkesë për libër nga detyra dhe i është aprovuar”, ka thënë Hoxha. Në vend të Gashit është emëruar komandanti i deritashëm i trafikut rajonal në Ferizaj, Ibrahim Shatrolli. Pesë zyrtarëve të Policisë së Kosovës që e kanë ndaluar të ndjerin më 7 korrik u është caktuar masa e paraburgimit prej një muaji, meqë dyshohen për kryeje të veprës penale “vrasje nga pakujdesia”. Rasti ka marrë vëmendje të konsiderueshme pasi nga pamjet e shpërndara në mediet sociale, që thuhet se janë nga rasti në Lipjan, viktimë duket



me duar të lidhura dhe në gjunjë, ndërsa më pas bartet me autoambulancë. Policia ka thënë se Zejnullahu dyshohet se ka qenë nën ndikimin e alkoolit dhe

ka sulmuar automjete dhe kalimtarë kur është ndaluar nga autoritetet e rendit. Mbrojtja e të pandehurve ka thënë më 9 korrik, pas seancës

dëgjimore, se nuk beson që zyrtarët e suspenduar kanë kontribuar apo shkaktuar rastin e vdekjes. Zyrtarë të lartë shtetërorë,

përfshirë presidenten e vendit, Vjosa Osmani, kryeministrin në detyrë, Albin Kurti dhe ministrin e Brendshëm në detyrë, Xhelal Sveçla, kanë bërë thirrje për hetime dhe zbardhje të rastit. Familja ka deklaruar se është e zhgënjyer me mungesën e deritashme të transparencës nga autoritetet. Vëllai i viktimës, duke folur për disa medie, ka thënë se familjarët nuk kanë marrë asnjë sqarim nga policia, ndërsa trupi i të ndjerit “ka pasur shumë shenja dhe thyerje”. Pjesëtarë të shoqërisë civile kanë shprehur shqetësim për mënyrën se si policia e ka menaxhuar rastin në Lipjan. Ata kanë vënë në dyshim nëse policët e përfshirë kanë pasur trajnim të mjaftueshëm, pasi trajnimi i tyre në Kosovë është zvogëluar nga gjashtë në tre muaj. Ekspertët kanë vlerësuar se kjo periudhë e shkurtër trajnimi nuk është e mjaftueshme për të përballuar situata komplekse në terren.

Çregjistrohet Lëvizja për Bashkim

PRISHTINË, 10 KORRIK - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka marrë vendim për çregjistrimin e partisë politike Lëvizja për Bashkim, e cila ka paraqitur në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (ZRCKFSP) vendimin dhe dokumentacionin mbështetës

për pushimin e të gjitha aktiviteteve politike. Pas këtij vendimi është bërë me dije se ZRCKFSP-ja do ta njoftojë Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) për bllokimin dhe deri në mbylljen e llogarisë bankare dhe Administratën Tatimore për fshirjen e numrit fiskal të LB-së, e cila është

drejtuar nga Valon Murati. Në mbledhjen e KQZ-së anëtarët e saj janë njoftuar lidhur me ecurinë e zbatimit të planit të aktiviteteve për organizimin e zgjedhjeve lokale për kryetarë të komunave dhe për kuvende komunale të cilat do të mbahen më 12 tetor 2025. /Kp



MILIONA EURO TË PEZULLUARA E NDIKIM NË INTEGRIM: SI NDIKUAN MASAT E BE-së NDAJ KOSOVËS QË S’U HOQËN KURRË?

PRISHTINË, 10 KORRIK - Tashmë janë bërë mbi dy vite që prej kur Kosova është vënë nën sanksione nga ana e Bashkimit Evropian (BE). Ato që nga dikush janë vlerësuar si sanksione e nga dikush si masa të përkohshme, i kushtuan vendit mbi 600 milionë euro projekte që janë pezulluar ose edhe janë vonua për një kohë të pacaktuar gjatë këtyre dy viteve. Përveç projekteve, sanksionet kanë pasur edhe ndikim tjetër, duke shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme të planeve të zhvillimit, duke penguar qeverisjen lokale dhe duke ndikuar në trajektoren e integritetit të Kosovës në BE.

Në një artikull të publikuar nga “EUNews” është theksuar që edhe pse këto të njëjtat janë cilësuar si të përkohshme, në realitet, po dëshmojnë të mos jenë as të përkohshme dhe as të ktheshme, as tani që Komisioni Evropian ka njoftuar se do të fillojë heqjen e tyre.

“Edhe nëse masat hiqen tani, ndikimi i vonesës dyvjeçare në këto projekte është më i madh se vlera e tyre nominale”, ka thënë Rrona Zhuri, koordinatore e kërkimit në Institutin GAP për Studime të Avancuara, e cila ka kryer analizën mbi ndikimin financiar të masave të BE-së në Kosovë.

Procedurë e paqartë

Në maj 2023, tensionet me Serbinë fqinje janë përshkallëzuar në veri të Kosovës, kur protestat kundër ndërhyrjes së policisë së Kosovës për të lehtësuar instalimin e katër kryetarëve të sapozgjedhur të bashkive u shndërruan në përleshje të dhunshme, duke përfshirë edhe trupat e KFOR-it të udhëhequra nga NATO. Protestat u udhëhoqën nga Lista Serbe, partia dominuese serbe në Kosovë, e cila mban lidhje të ngushta me presidentin serb, Aleksandër Vučić.

Pas një votimi unanim në Këshill, BE-ja ka miratuar masa “të përkohshme dhe të ktheshme” kundër Kosovës më 28 qershor 2023, në përgjigje të asaj që Komisioni e ka përshkruar si “mungesë bashkëpunimi” nga autoritetet në Kosovë në qetësimin e situatës në veri. Që atëherë, BE-ja ka pezulluar të gjitha vizitat dypalëshe, përveç atyre të kryera si pjesë e Dialogut Serbi-Kosovë të lehtësuar nga BE. Pasoja financiare kanë qenë gjithashtu të konsiderueshme. Financimi përmes Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimi (IPA) është ngrirë dhe propozimet e paraqitura sipas Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) nuk po shqyrtohen më nga Bordi Menaxhues i WBIF.

Këto masa nuk klasifikohen zyrtarisht si sanksione, të cilat do të kërkonin miratim unanim nga të 27 shtetet anëtare çdo gjashtë

muaj për rinovim – por në vend të kësaj ndjekin një procedurë sipas kornizës së Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (CFSP), e cila gjithashtu kërkon unanimitet në Këshill për heqjen e tyre.

Në përfundimet e dhjetorit 2024 mbi zgjerimin, Këshilli deklaroi se BE-ja “do t’i heqë gradualisht” këto masa “paralelisht me hapat e mëtejshëm” të ndërmarrja nga autoritetet e Kosovës. Si pasojë, Komisioni ka njoftuar se kishte filluar punën për një heqje “graduale, të kushtëzuar dhe të ktheshme”. Megjithatë, kur është pyetur për sqarime, një zëdhënës i BE-së nuk ka pranuar të jepte detaje në lidhje me procedurën, një afat kohor të mundshëm dhe kushtet që Kosova duhet të përmbushë në lidhje me “përparimin në terren” dhe “çtensionimin e qëndrueshëm” në veri të Kosovës. “Ato duhet të revokohen plotësisht dhe pa vonesë”, ka thënë Riho Terras, raportuesi i Parlamentit Evropian për Kosovën, për Parlamentin. Nëse objektivi i BE-së është të rivendosë dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, “trajtimi i padrejtë i Kosovës nuk e mbështet këtë objektivi”, ka theksuar ai, duke vënë në dukje se meqenëse sjellja e Serbisë mes tensioneve në rritje në rajon nuk është përmbushur me asnjë masë të BE-së është “krejtësisht e papranueshme” që masat ndëshkuese kundër Kosovës nuk janë hequr ende “pa vonesë”.

Ndikimi i sanksioneve të BE-së në terren

Masat kanë shkaktuar ndërprerje të konsiderueshme të planeve të zhvillimit, kanë penguar qeverisjen lokale dhe kanë ndikuar në trajektoren e integritetit të Kosovës në BE. Sipas një raporti të publikuar në qershor nga Instituti për Studime të Avancuara GAP, një grup ekspertësh në Kosovë, shkalla e dëmit është e konsiderueshme. Sipas vlerësimeve të përgjithshme, projektet me vlerë afërsisht 613.4 milionë euro janë vonuar, pezulluar ose janë lënë në pritje për një kohë të pacaktuar. Kjo përfshin grantet e humbura, zhvillimet e shtyra të infrastrukturës dhe aksesin e bllokuar në sektorë thelbësorë si energjia, arsimi, mjedisi dhe dixhitalizimi. Për një vend të vogël si Kosova, i cili mbështetet shumë në ndihmën e BE-së për investime publike dhe planifikim zhvillimor, pasojat kanë qenë të gjera dhe të ndjera thellë.

Në zemër të ndikimit financiar qëndron pezullimi i projekteve në kuadër të IPA II dhe IPA III, dy instrumente kyçe të BE-së për mbështetjen e vendeve candidate dhe candidate potenciale. Së bashku, projekte me vlerë rreth 218 milionë euro janë prekur. Marrëveshja IPA e vitit 2020 ka



parashikuar 32.1 milionë euro në projekte të pezulluara, duke përfshirë një investim jetësor prej 25 milionë eurosh në sistemin e ngrohjes qendrore dhe 7.1 milionë euro në fonde të humbura plotësisht për shkak të afateve të humbura për fillimin e projekteve. Këto fonde u destinuan për fusha kritike si bujqësia, turizmi rural dhe rritja e konkurrencës në biznesit. Marrëveshja IPA e vitit 2021 përfshinte 37.5 milionë euro në projekte që janë ndaluar gjithashtu. Këto mbulonin një sërë fushash: mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin bujqësor dhe rural, reformat e tregut dhe rristurimin e administratës publike. Ndër programet e prekura ishte “Skema e Qelizave të Reja”, një iniciativë kryesore që ofronte bursa për studentët kosovarë që synonin të ndërtonin ekspertizë në ligjin, qeverisjen dhe administratën e BE-së, e parë si thelbësore për përgatitjen e shërbimit civil të Kosovës për integritetin në BE.

Edhe më me pasoja ishte ngrirja e të gjithë paketës IPA 2022, me vlerë 91.83 milionë euro. Këto fonde ishin ndarë për të mbështetur reformat kyçe, duke përfshirë të drejtat themelore, zhvillimin socio-ekonomik, përpjekjet për tranzicion të gjelbër dhe harmonizimin ligjor me normat e BE-së. Megjithëse paketa IPA 2023 u kursye kryesisht, me 90 për qind të grantit të saj prej 75 milionë euro të fokusuar në energji të shpërndarë në kohë, planet nën IPA 2024, me vlerë 56.4 milionë euro, janë vonuar dhe tani janë caktuar për riprogramim në ciklin 2025-2027. Këto përfshijnë projekte në reformën e sektorit të drejtësisë, anti-korrupsionin, energjinë, kulturën dhe arsimin e hershëm – sektorë në thell të përafrimit të Kosovës me BE-në. Përveç projekteve të pezulluara të IPA-s, janë prekur edhe rreth 395.5 milionë euro projekte në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) – të financuara bashkërisht nga BE-ja, institucionet financiare

ndërkombëtare dhe donatorët dypalësh.

Rreth 395.5 milionë euro në aplikime për projekte janë bllokuar. Këto përfshijnë ndërmarrje të mëdha të bashkëfinancuara me Bankën Evropiane të Investimeve (BEI), Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bankën Botërore, të cilat kishin për qëllim modernizimin e infrastrukturës fizike dhe dixhitale të Kosovës. Sipas raportit të Institutit GAP, ndër sektorët më të goditur është mjedisi, i cili përbën 350.7 milionë euro në financim të ngrirë ose të vonuar. Sektori i energjisë vjen nga afër, me 114.4 milionë euro në projekte të prekura.

Dixhitalizimi, një përparësi për administratën publike dhe sistemin arsimor të Kosovës, ka pësuar gjithashtu pengesa. Rreth 57 milionë euro në projekte të financuara nga WBIF që synojnë zgjerimin e internetit me shpejtësi të lartë dhe përmirësimin e infrastrukturës së të dhënave janë pezulluar. Ndërkohë, sektori i kulturës ka parë 15 milionë euro në investime të mundshme të ngrira – fonde që do të kishin mbështetur ndërtimin e një sale koncertesh kombëtare dhe galeri arti në Prishtinë. Këto projekte ishin hartuar për t’u financuar përmes një përzjerjeje grantesh, kredish dhe kontributesh kombëtare të BE-së. Shkalla e këtij pezullimi ka krijuar një boshllëk në financimin publik, duke kufizuar rëndë aftësinë e Kosovës për të zbatuar agjendën e saj të zhvillimit strategjik.

Ndër më të rëndësishmet është projekti i sistemit të ngrohjes qendrore prej 25 milionë eurosh (Termokos), një iniciativë kyçe energjetike nga marrëveshja IPA 2020. Nga kjo shumë, 17.6 milionë euro u premtuan nga BE dhe 7.4 milionë euro nga Kosova. Një tjetër projekt i rëndësishëm, restaurimi i Kinemasë Lumbardhi në Prizren, me vlerë 800,000 euro, është humbur plotësisht. “Për ne,

ky ka qenë një projekt jetësor. Një nga qëllimet kryesore të organizatës sonë ka qenë restaurimi i kinemasë më të vjetër në Kosovë. Restaurimi synonte gjithashtu të eliminonte çdo përpjekje ose ide për ndryshim. Ne kemi avokuar për këtë që nga viti 2015, kur u themelua organizata jonë. Procesi është zgjatur jashtëzakonisht shumë — filloi në vitin 2017 me dialogun tonë fillestar dhe angazhimin e tyre të parë parësor. Jemi përballur me vonesa të konsiderueshme, shumë paqartësi dhe mungesë qartësie. Në fund, morëm një letër me tre rreshta nga Zyra e BE-së për Bashkëpunim ku thuhej se u vinte keq, por projekti u anulua për shkak të sanksioneve të vendosura”, ka thënë Ares Shporta, drejtor i Fondacionit Lumbardhi. Programi më i madh i pezulluar IPA është iniciativa “BE për Mjedisin dhe Energjinë e Rinovueshme” në kuadër të IPA 2022, me vlerë 68.85 milionë euro, e cila synonte të mbështeste projekte në mbrojtjen e mjedisit, energjinë dhe zhvillimin profesional.

Pasoja nuk kufizohen vetëm në objektivat financiare të humbura, ato jehojnë në të gjitha institucionet dhe shoqërinë e Kosovës. Vonesat kanë çuar në rritje të kostove, humbje të momentit në reformat jetësore dhe përkeqësim të shërbimeve në energji, arsim dhe mbrojtje të mjedisit. Qeveritë lokale, veçanërisht në komunat më të vogla, janë përballur me një krizë kapaciteti, me disa projekte të ndaluara në mes të procesit. Shoqata e Komunave të Kosovës ka paralajmëruar se ndërprerja e financimit të BE-së ka rezultuar në shkurtime të mëdha në ofrimin e shërbimeve, duke përkeqësuar pabarazitë midis rajoneve më shumë dhe më pak të zhvilluara.

***Ky artikull u prodhua si pjesë e Rrjeteve Tematike të PULSE, një iniciativë evropiane që mbështet bashkëpunimet gazetareske transnacionale.**

BB-ja E LARGON KOSOVËN NGA LISTA E VENDEVE ME SITUATA TË BRISHTËSISË DHE KONFLIKTIT, BQK-ja MIRËPRET VENDIMIN

PRISHTINË, 10 KORRIK - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka mirëpritur vendimin e Bankës Botërore (BB) për ta larguar zyrtarisht Kosovën nga Lista e Vendeve me Situata të Brishtësisë dhe Konfliktit (FCS - Fragile and Conflict-Affected Situations), e njohur gjithashtu si lista FCV. Ky vendim i rëndësishëm është konfirmuar përmes një shkrese zyrtare të pranuar nga Banka Botërore, ndërsa lista e përditësuar tashmë është publikuar në faqen zyrtare të institucionit ndërkombëtar. Largimi nga kjo listë konsiderohet si një moment domethënës për Republikën e Kosovës, duke reflektuar progresin e vendit në forcimin e qëndrueshmërisë institucionale, stabilitetit makroekonomik, qeverisjes

financiare dhe sundimit të ligjit. Sipas Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), ky sukses është rezultat i angazhimeve të përbashkëta ndërinstitucionale, në veçanti me Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, si dhe i përkushtimit të vazhdueshëm të BQK-së në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Çështja e largimit nga kjo listë ishte adresuar me theks gjatë Takimeve Pranverore të FMN-së dhe Bankës Botërore në prill të këtij viti në Uashington D.C., ku delegacioni i BQK-së, i udhëhequr nga guvernatori, zhvilloi takime të drejtpërdrejta me drejtues të lartë të këtyre institucioneve. Përfitimet kryesore nga largimi nga lista FCS: përmirësimi i perceptimit ndërkombëtar për stabilitetin institucional dhe



ekonomik të Kosovës; rritja e besimit të investitorëve dhe ulje e vlerësimeve për rrezik financiar; qasje më e favorshme në financim zhvillimor dhe kapital privat

dhe komplementimi i vlerësimit të parë të kredisë sovraane për Kosovën, që reflekton trendin pozitiv në qeverisje dhe ekonominë e vendit. BQK-ja ka theksuar se kjo arritje forcon besueshmërinë ndërkombëtare të Kosovës dhe përkrah përpjekjet e institucioneve për zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje financiare dhe integrim evropian. Në fund, BQK-ja ka shprehur mirënjohje për menaxhmentin e Bankës Botërore dhe është zotuar për vazhdimin e reformave, thellimin e transparencës dhe forcimin e partneriteteve ndërkombëtare në shërbim të stabilitetit makro-financiar dhe përparimit të Kosovës në arenën globale.

KOMPANIA E VËLLAIT TË SHEFIT TË KABINETIT TË KURTIT MERR LICENCË NGA ZRRE-ja PËR TREGTI ME ENERGJI

PRISHTINË, 10 KORRIK - Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZrRE) ka licencuar për tregtim të energjisë kompaninë "Management & Development Associates L.L.C.", e cila është themeluar nga Luan Dali, shef i kabinetit të kryeministrit në detyrë, Albin Kurti. Në njoftimin për medie, ZrRE-ja ka treguar se në mbledhjen e bordit një licencë e tillë i është dhënë edhe një kompanie tjetër. "Më 10.07.2025, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për energji ka mbajtur seancën e tetë (VIII) për vitin 2025. Në këtë seancë Bordi ka shqyrtuar dhe aprovuar aplikacionet për licencim të aktivitetit për furnizim me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike të 'Energy Kosova V.B' sh.p.k dhe 'Management & Development Associates' sh.p.k. Në këtë seancë janë shqyrtuar dhe aprovuar edhe kërkesat e



njëmbëdhjetë (11) subjekteve juridike dhe katërmëdhjetë (14) personave fizik për marrje të autorizimit për vetë-konsum, me kapacitet total të

instaluar prej 1282 kW. Pjesë e shqyrtimit nga Bordi kanë qenë edhe ankesat e konsumatorëve dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin

e Zyrës së Rregullatorit për Energji. Të gjitha vendimet e Bordit të ZrRE-së do të publikohen në faqen elektronike të ZRRE-së", është

thënë në njoftimin e ZrRE-së. Ndaj vendimit të ZrRE-së ka reaguar deputetja e PDK-së, Vlora Çitaku. Ajo ka thënë se dhënia e licencës për vëllanë e shefit të kabinetit të Kurtit nuk ka qenë befasi. Në këtë kontekst, Çitaku ka shkruar në "Facebook" se krimi në sektorin e energjisë ka marrë përmasa galopante. "E vërtetë, kjo nuk është aspak befasi. Krimi në sektorin e energjisë ka marrë përmasa galopante. Sot, gjithçka vendoset në grupe të mbyllura në 'WhatsApp', nga tenderët, te licencat, e deri te ndërprerjet e energjisë elektrike. Dhe në ato grupe janë të përfshirë krerët e kupolës së Vetëvendosjes, ashtu siç tashmë është e dokumentuar edhe nga Prokuroria. Por faturën nuk e paguajnë ata. Faturën, me gjithë pasojat, po e paguajnë qytetarët, çdo muaj, çdo ditë, çdo orë", ka shkruar Çitaku.

ATK-ja mbledh mbi 500 milionë euro tatime për gjashtë muaj

PRISHTINË, 10 KORRIK - Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka bërë me dije se kanë inkasuar 524.1 milionë euro të hyra tatimore gjatë periudhës janar-qershor 2025. Ai ka thënë se kjo paraqet një rritje prej 50.9 milionë eurosh apo 10.8 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Murtezaj këto të dhëna i ka paraqitur të enjten në një konferencë për medie, duke shtuar se ATK-ja ka vazhduar

ngritjen e performancës pothuajse në të gjithë indikatorët matës. "Gjatë këtyre gjashtë muajve, ATK-ja ka vazhduar me përkushtim të zbatojë prioritetet strategjike si rritjen e mbledhjes së të hyrave, luftimin e ekonomisë joformale, zgjerimin apo rritjen e përdorimit të teknologjisë në shërbim ndaj tatimpaguesve dhe përmirësimin e kulturës së përgjithshme tatimore në vend. Administrata Tatimore e Kosovës edhe në këtë periudhë raportuese, sikurse edhe në katër

vitet e fundit, vazhdoi me ngritje të performancës pothuajse në të gjithë indikatorët matës. Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2025 kemi inkasim të të hyrave tatimore mbi 524.1 milionë euro, që do të thotë se kemi rritur të hyrat mbi 51 milionë euro apo 11 për qind, në raport me vitin paraprak", ka thënë Murtezaj. Murtezaj ka theksuar se krahas rritjes së të hyrave, ATK-ja është duke vazhduar edhe reformën institucionale, konkretisht reformën në procesin e fiskalizimit.



ÇFARË MUND TA MËSOJË RËSINË E PUTINIT, OPERA MË E ERRËT E ÇAJKOVSKIT



Nga: Simon HEFFER / *The Daily Telegraph*

Fidelio e Beethovenit dhe Mbretëresha e Maçit e Çajkovskit [Tchaikovsky] janë si dy pika mbështetëse të operës së shekullit XIX. Fidelio u shfaq për herë të parë në vitin 1806 (edhe pse versionin që luhet zakonisht sot është rezultat i shumë rishikimeve dhe daton nga viti 1814), ndërsa Mbretëresha e Maçit u vu në skenë më 1890. Vepra e Beethovenit, në shumë drejtime, ndërpret në mënyrë radikale traditën e operës së shekullit XVIII, ashtu siç shumëçka nga muzika e tij u shpëput nga idetë e Haydnit dhe mjeshtërve të tjerë të atij shekulli. Vepra e Çajkovskit jo vetëm që vazhdoi deri-diku këtë linjë të Beethovenit, por i ktheu sytë prapa drejt epokës së Mozartit – ndikimit dhe stilit të të cilit Beethoveni përpiquej t’i shmangej, sidomos në vitet e tij të hershme (edhe pse jo gjithmonë me sukses). Këto opera janë shfaqur me produksione të shquara në Garsington këtë sezon, nën drejtimin muzikor të të talentuarit Douglas Boyd. Beethoveni e përjetoi Fidelion, si një përpjekje të vështirë, dhe nuk shkroi më kurrë një tjetër operë. Duket se nuk ishte aq sfidë për

talentin e tij të pakufishëm në krijimin e muzikës origjinale dhe tërheqëse – sepse Fidelio e ka këtë – sa për aftësinë për ta përshtatur muzikën me strukturën e zakonshme të operës. Fillimisht me tri akte, më vonë u kthye në dy. Ai shkroi një uverturë që dëshmon shkëlqimin e tij në kompozimin orkestral, por disa produksione zgjedhin të mos e interpretojnë fare. Dhe, ndonëse përpieqet (me vetëdije apo jo) të krijojë diçka ndryshe nga opera tradicionale, Beethoveni përfshin pjesë recitativi që duken se nuk kanë vend, madje tingëllojnë bezdisëse edhe në realizimet më të mira – siç është edhe ajo e Garsingtonit. Megjithatë, për mendimin tim, Fidelio është një urë lidhëse midis stilit operistik të Mozartit, që u formësua 10 vjet para se Beethoveni të shkruante operën, dhe atij të Wagnerit që u zhvillua 30 vjet më vonë. Produksioni i Garsingtonit – i thjeshtë dhe i shkëlqyer, fillimisht i krijuar më 2009 nga John Cox dhe i rikthyer këtë herë nga Jamie Manton – arrin të përcjellë një rrëfim të qartë, gjë që kompozitori dhe libretisti e kishin arritur vetë, por që disa regjisorë, duke dashur të bien në sy, preferojnë ta ngatërrojnë. Opera rrëfen historinë e Leonorës, burri i së cilës, Florestani, është burgosur në një qeli të thellë në Spanjë

sepse përpiquej të denonconte korrupsionin dhe padrejtësitë e guvernatorit Pizaro. Florestani është hedhur në qelinë më të errët me pranga dhe është përhapur fjala se ka vdekur. Por, Leonora nuk e beson këtë dhe maskohet si djalosh – si Fidelio – për të punuar si ndihmës i rojës së burgut dhe për të zbuluar të vërtetën. Rojtari Roko merr urdhër nga Pizaro për të vrarë Florestanin. Roko refuzon, por e çon Fidelion në bodrum për të ndihmuar në gjurmimin e varrit të tij. Leonora e njuh burrin e saj; ndodh një përballje ku ajo kërcënon Pizaron me armë, Florestani lirohet, dhe Pizaro përfundon në burgun që vetë kishte krijuar, për t’u ndëshkuar. Beethoveni shkroi këtë vepër nën ndikimin e traditës së “operave të shpëtimit” që u zhvilluan pas Revolucionit Francez – ku, pas shumë vështirësive, një i burgosur i pafajshëm shpëtohet. Kjo vepër përputhej me ideat politike të Beethovenit dhe i jepte mundësi të shpëtonte nga ajo që ai e konsideronte si lehtësi dhe pavlefshmëri në shumicën e operave të Mozartit dhe bashkëkohësve të tij. Ideja e drejtësisë ishte jetike për Beethovenin, dhe duke e treguar këtë histori në mënyrë kaq të thjeshtë, ai kurrë nuk e megjullon mesazhin. Trupa e Garsingtonit është aq e mirë,

sa do të ishte padrejtësi të veçoje disa individë për lëvdata. Megjithatë, Sally Matthews është një Fidelio bindëse, në çdo aspekt, dhe Robert Murray nuk ishte hiç më pak se i jashtëzakonshëm si Florestan. Shfaqja do të vazhdojë gjatë gjithë korrikut dhe, nëse arrini të siguron bileta, nuk do të zhgënjeheni. Fatkeqësisht, prodhimi i Mbretëreshës së Maçit nga Jack Furness në Garsington sapo ka përfunduar, por ishte aq mbresëlënës sa që kompania do të ishte e pamend nëse nuk e rikthen së shpejti. Opera e dhjetë nga njëmbëdhjetë të cilat Çajkovski kompozoi, është – së bashku me Eugjen Onjeginin – e vetmja që luhet rregullisht sot. Ashtu si Onjegini, edhe kjo bazohet në një tregim të Pushkinin që trajton pasojat fatale të dashurisë obsesive – dhe asnjë nga operat nuk përfundon mirë. Regjia e Furnessit vë në kontrast sjelljen gati të zbrazët dhe të plogësht të aristokracisë ruse të viteve 1770, me obsesionin e thellë dhe dëshpërues të Hermanit – një antihero dhe i huaj në atë shoqëri – për Lizën, mbesën e një konteshe, e fejuar me një princ. Hermani ëndërron të ketë mjaft para për t’u martuar vetë me Lizën dhe, kur dëgjon se kontesha e di sekretin e letrave që sjellin fitore në lojën e bixhozit, vendos me çdo

kusht ta marrë atë sekret prej saj. Por, ndërsa e ngacmon për t’ia treguar, ajo bie dhe vdes. Megjithatë, ajo i shfaqet si fantazmë – ose të paktën ai kështu mendon, pasi deri në atë pikë është e qartë se ai ka humbur mendjen dhe më herët kishte halucinacione se po qëllonte mbi Katerinën e Madhe – dhe i tregon sekretin e letrave. Hermani shkon në sallën e bixhozit dhe, për dy letrat e para, ashtu siç i ka thënë fantazma, fiton një shumë të madhe. Pastaj vë bast gjithçka mbi letrën e tretë, që beson se është Asi i Maçit. Por, në të vërtetë është Mbretëresha dhe ai humbet përballë rivalit të tij në dashuri, Princit, i cili kështu merr hak. Hermani qëllon veten dhe vdes ngadalë. Çajkovski vdiq brenda tre vjetësh, sipas shumë gjasave nga vetëvrasja. Errësira në këtë opera është mbytëse. Ironikisht, Liza e donte Hermanin për atë që ishte, jo për pasurinë që ai mund të fitonte, dhe kështu tragjedia thellohet nga ironia. Dhe, vetëm pak çaste pas vdekjes së Hermanit, bixhozxhinjtë rikthehen të luajnë letra, sikur ai të mos kishte ekzistuar kurrë. Ka një metaforë të qartë këtu për Rusinë e sotme – dhe opera përfaqëson një kohë të shkëlqimit kulturor që, në atë vend të errësuar, tani duket se është humbur përgjithmonë. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

KOSOVA NGRIHET PËR DY POZITA NË RENDITJEN E FIFA-S

“Epoka e re”

PRISHTINË, 10 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka shënuar ngritje në renditjen e re të FIFA-s. “Dardanët” tash janë ngritur për dy pozita dhe tash renditen në vendin e 95-të. “Kosova shënon ngritje në renditjen e re të FIFA-s, e 95-ta në botë. Kombëtarja e Kosovës ka vazhduar me progres në renditjen më të fundit të FIFA-s, duke u ngjitur për dy pozita. Ky avancim pasqyron formën e mirë dhe paraqitjet pozitive të ekipit dardan në ndeshjet e fundit, duke dëshmuar zhvillimin dhe përparimin e vazhdueshëm të Kosovës në arenën ndërkombëtare”, thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës.

Dy barazime në dy sfidat e fundit, kundër Serbisë dhe Letonisë, kanë pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në renditjen mujore të publikuar nga FIFA. Me 1373 pikë, tani Shqipëria pozicionohet në vendin e 68 duke humbur edhe dy pozicione të tjera. Kjo është pika



më e ulët që kuqezinjtë kanë prekur që nga koha kur Sylvinho zbarkoi në Tiranë. Më saktë, tekniku brazilian e gjeti Shqipërinë në këtë pozicion dhe pas rreth dy viteve rikthehemi në gjendjen fillestare. Një pozicion ka humbur edhe rivali ynë kryesor në Grupin K në kualifikueset e

Botërorit, Serbia. Ekipi ballkanas renditet në vendin e 32-të. Kryesuesi i grupit tonë, Anglia, qëndron në vend numëro, e katërta për muajin korrik. Në pesë vendet e para nuk ka asnjë ndryshim, me renditjen e FIFA-s që kryesohet nga Argjentina, e ndjekur nga Spanja dhe Franca.

ADEMI TAKON KRYETARIN E FUSHË-KOSOVËS DHE VITISË



PRISHTINË, 10 KORRIK (ER) - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, është takuar të enjten me kryetarin e komunës së Fushë-Kosovës, Burim Berisha, më pas edhe me kryetarin e komunës së Vitisë, Sokol Haliti. “Diskutuam për një temë që na bashkon të gjithëve, të ardhmen e futbollit tonë, konkretisht për ndërtimin e fushave të reja, në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit me këtë komunë. Është gjithmonë



inkurajuese dhe motivuese të shohësh përkushtimin e kryetarëve të komunave për të investuar në sport dhe për të bashkëpunuar për zhvillimin e infrastrukturës sportive në vendin tonë. E falënderova kryetarin Burim Berisha për bashkëpunimin dhe mbështetjen konkrete për futbollin dhe të rinjtë e kësaj komune”, ka shkruar Ademi. “Në këtë takim miqësor diskutuam për projekte konkrete që lidhen me ndërtimin e fushave të reja

të futbollit në Komunën e Vitisë, si pjesë e Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me këtë komunë. Përkushtimi i kryetarëve lokalë si z. Haliti për të investuar në infrastrukturën sportive është thelbësor për të krijuar kushte më të mira për të rinjtë, për klubet dhe për zhvillimin e futbollit në Viti. Falënderova kryetarin Haliti për gatishmërinë dhe bashkëpunimin”, ka shtuar Ademi.

SHKURT

Presidenti i Club Brugges: Jashari nuk do të largohet

Përkundër tentimit dhe ofertave nga skuadra e Milanit, te Club Brugge janë të vendosur për ta mbajtur mesfushorin Ardon Jashari. Në fakt, duket se Jashari edhe në sezonin 2025/26 do ta bartë fanellën e klubit belg, ka bërë me dije presidenti i Brugget, Bob Madou. Ai ka pranuar se ka biseduar me Milanin për Jasharin, por ka insistuar se nuk ka ofertë që mund ta bindë në lirim të 23-vjeçarit. Sipas kreut të Brugget, Jashari nuk do të largohet për shkak se vlerësohet lojtar tejet i rëndësishëm për ekipin, sidomos në sezonin e ri. “E kuptoj që Ardoni mund të jetë i dëshpëruar, por ai e di se çka pres prej tij. Kështu që, ai do të qëndroj te Brugge”, ka thënë Madou. Milani kishte bërë disa oferta për Jasharin, të fundit në vlerë prej 35 milionë eurosh, por duket se dështoi në transferimin e tij, sikurse në atë të Granit Xhakës nga Bayer Leverkuseni.

Peja 03 për herë të parë në FIBA EuroCup Women

Peja 03 do të jetë pjesë e garës shumë të rëndësishme evropiane në basketboll të femrat, FIBA EuroCup Women. Kjo do të jetë hera e parë që nënkampionia e Kosovës garon në FIBA EuroCup Women. Skuadra nga Peja do të mundohet ta përfaqësojë sa më mirë vendin tonë në këtë ligë të fortë evropiane, derisa ka filluar përforsimet për një edicion sa më të suksesshëm. Në edicionin e ri do të garojnë 48 skuadra, ku do të ndahen 12 grupe me nga katër skuadra. Shorti për edicionin e ri do të hidhet më 23 korrik, e mërkurë. Më herët në këtë ligë ka garuar KBF Prishtina.

Amos Dadet paraqitet te KF Prishtina e Re

KF Prishtina e Re e ka paraqitur mesfushorin Amos Dadet, i cili është 25-vjeçar dhe vjen nga Nigeria. KF Prishtina e Re ka kënaqësinë të njoftojë për afrimin e mesfushorit defensivë Amos Dadet, 25-vjeçar nga Nigeria. “Amos së fundmi ishte pjesë e ekipit Voska Sport në Maqedoninë e Veriut, ku në edicionin e fundit zhvilloi 24 paraqitje, duke treguar një performancë të qëndrueshme në mesfushë. Me energji, disiplinë dhe aftësi për ta kontrolluar mesfushën, Amos pritet të sjellë një dimension të ri për skuadrën tonë në Superligë”, thuhet në njoftimin e Prishtina e Re.

Kosova U20 në BVA Ballkanikun e Beach Volley

Në Schinas të Greqisë ka nisur faza e parë kualifikuese për Kampionatin Evropian U20 në beach volley, e cila zhvillohet në kuadër të Kampionatit Ballkanik, nën

organizimin e BVA (Asociacioni Ballkanik i Volejbollit). Në këtë fazë marrin pjesë 8 ekipe: Greqia dhe Turqia me nga dy ekipe, si dhe Kosova, Bullgaria,

Moldova dhe Rumania me nga një ekip. Kosova përfaqësohet nga dyshja e re dhe premtuese Dilon Latifaj dhe Erind Qalaj, nën drejtimin e Fatlum Hajrizit, të

cilët të enjten kanë zhvilluar stërvitjen e parë në ambientet e turneut. Shorti për grupet do të hidhet sonte, ku do të mësohen edhe kundërshtarët e Kosovës në

rrugëtimin drejt kualifikimit për Kampionatin Evropian FVK-ja u dëshiron shumë suksese përfaqësuesve tanë në këtë fazë të rëndësishme garuese

Hamiltoni mbron Vasseurin: Është njeriu i duhur për të na çuar në majë, prej tij jam te Ferrari

LONDËR, 10 KORRIK - Piloti britanik Lewis Hamilton e ka mbështetur përsëri Frederic Vasseur, drejtorin sportiv të Ferrarit, i cili, në mes të sezonit, ende nuk është konfirmuar në këtë detyrë për vitin tjetër. "Mendoj se Fred është vërtet njeriu i duhur për të na çuar në majë. Kjo është arsyeja pse po punoj sa më

shumë që mundem për ta mbështetur atë dhe për t'i bërë ndryshimet e nevojshme të cilat janë mjaft të shumta", ka thënë Hamiltoni. "Më pëlqen të punoj me Vasseur. Ai është arsyeja pse jam këtu dhe duam të vazhdojmë së bashku. Ai ka mbështetjen time të plotë. Fred më solli në këtë ekip, kështu që i detyrohem shumë.

Sapo arrin në një ekip të ri vëren se sa i shkëlqyer është organizimi dhe si është ngritur struktura. Ata që kanë ardhur së fundmi kanë një perspektivë të freskët krahasuar me ata që kanë qenë atje për një kohë të gjatë. Dhe kështu mund t'i shihni qartë anët pozitive dhe negative", ka deklaruar shtatë

herë kampioni i botës në Formula 1. Deklaratë kjo e dhënë gjatë një interviste me transmetuesin britanik "Channel 4", që i bën jehonë asaj që tha Sir Lewis pak më pak se një muaj më parë, para garës në Kanada, kur Hamiltoni pranoi se ishte drejtuesi francez që e bindi të vijë te Ferrari.



Enrique: Po shkruajmë historinë. Alonso: Kemi shumë punë

TRENTON, 10 KORRIK - Suksesi fantastik ndaj Real Madridit, fitorja me "poker" golash dhe loja e shfaqur, i dhurojnë një kënaqësi të pamasë një ish-katalanasi të famshëm si Luis Enrique, suksesi ndaj rivalit të tij personal të përjetshëm e dërgon në del trajnerin e PSG-së, por askush nuk dëshiron të ndalet këtu, në Paris kërkojnë trofeun e fundit dhe të pestë për këtë vit fantastik: "Ndihehem shumë mirë, shkëlqyeshëm. Është gjithnjë e vështirë të përballesh me Real Madridin në këto kushte, është shumë vapë. E nisëm ndeshjen shumë mirë dhe jemi të kënaqur për paraqitjen tonë. Ky është një sezon special për ne. Tani na mungon dhe një hap i fundit kundër një skuadër të madhe si Chelsea. Duhet të rikuperojmë për t'u paraqitur në kushte të mira në finale. Ne dëshirojmë ta shkruajmë historinë tonë te ky klub, më pas t'i marrim



pushimet", u shpreh Luis Enrique pas ndeshjes. I ndryshëm është diskutimi në radhët e Real Madridit, kjo humbje vërtetoi se Xabi Alonso nuk ka "shkopin magjik", i duhet ende kohë për ta rikthyer ekipin në nivele të larta. "Fillimi i ndeshjes na la një shenjë të thellë. U bë shumë më e vështirë për ne pas 10 minutash. Duhet ta pranojmë këtë humbje, të bën të

ndihesh keq, por nuk duhet ta pranojmë. Në këto çaste nuk duhet ta humbasim qetësinë, duhet ta analizojmë këtë ndeshje me qetësi. Jemi ende në fillimin e punës, por është e qartë që duhet të bëjmë përmirësime. Vinicius jr-Mbappe së bashku? Në këtë ndeshje nuk funksionuam si skuadër. Është e vështirë të flasësh për individë apo situata individuale", ka deklaruar Alonso.

Modriq - Real, fundi i një epoke magjike dhe të lavdishme

Luka Modriq i dha fund epokës së lavdishme me Real Madridin. Legjenda kroate ka lënë gjurmë të pashlyeshme në "Santiago Bernabeu" ku arriti të bëhej një prej mesfushorëve më të mirë në histori të futbollit. 39-vjeçari u inkuadrua në minutat e fundit të ndeshjes gjysmëfinale të Botërorit të Klubeve mes Real Madridit dhe Paris Saint-Germainit, e cila ishte edhe paraqitja e tij e fundit në fanellën e "Los Blancos". Me mbretërit, ish-futbollisti i Tottenhamit i ka zhvilluar 597 ndeshje zyrtare që prej transferimit aty prej më shumë se një dekade, kur në krye të ekipit ishte Jose Mourinho. Në këtë periudhë, "Magjistari kroat" i ka fituar plot 28 trofe, duke u bërë



futbollisti më i trofeshëm në histori të klubit madrilen. Modriq ka fituar gjithçka që mund ta fitojë një lojtar, përfshirë këtu Ligën e Kampionëve, La Ligan, Kupën e Spanjës, Superkupën e Spanjës, Superkupën e Evropës dhe Botërorin e Klubeve. Ndër të tjera, ai e ka fituar edhe Topin e Artë në vitin 2018. Përfaqësuesi kroat i ka shënuar 43

gola me fanellën e bardhë, ndërsa i kishte edhe 95 asistime. Fatkeqësisht, ai u largua nga Madridi në sezonin me zero trofe. Kroati ka arritur marrëveshje me Milanin si lojtar i lirë pasi i skadoi kontrata me "Mbretërit". Ai do të luajë së paku një vit në "San Siro", duke vendosur më pas nëse do të pensionohet apo do të vazhdojë të luajë edhe një vit tjetër.

SHKURT

Hendersoni largohet nga Ajaxi

Ajaxi dhe Jordan Hendersoni kanë shkëputur kontratën. Kjo është bërë zyrtare të enjten nga klubi i madh holandez. Anglezi Henderson kishte kontratë edhe një vit, por bëri kërkesë për ndërprerje të bashkëpunimit. Dhe kërkesa u aprovua nga Ajaxi. Ai i ishte bashkuar Ajaxit në janar të vitit të kaluar nga skuadra arabe Al-Ettifaq. Me skuadrën holandeze i bëri 57 paraqitje. 35-vjeçari luan në mesfushë, ndërsa ka bërë karrierë të gjatë te Liverpooli. Te skuadra e madhe angleze ishte prej vitit 2011 deri në vitin 2023. Më herët ishte edhe te Sunderlandi dhe Coventry City. Hendersoni është reprezentues i Anglisë, ndërsa i ka 84 paraqitje e tri gola.

Ish-lojtari i NBA-së dënohet me 8 vjet burg për përdhunimin e një 21-vjeçareje

Ben McLemore, i cili u shpall fajtor ditët e fundit për përdhunimin e një 21-vjeçareje në një festë në vitin 2021, është dënuar me tetë vjet burg. McLemore i kishte mohuar akuzat, duke thënë se marrëdhënia seksuale ishte konsensuale, por gjykata nuk u bind nga ish-lojtari 32-vjeçar i NBA-së dhe ish-lojtari i AEK-ut. 21-vjeçarja pretendoi se u zgjua e dehur pas një feste në shtëpinë e ish-shokut të skuadrës së McLemore, Robert Covington, dhe 32-vjeçari e përdhuno. McLemore luajti për klubin turk Merkezefendi sezonin e kaluar dhe luajti në NBA për nëntë sezone, ku bëri 571 paraqitje.

Messi shënon dy gola dhe vendos një rekord të ri në MLS, kalon Pelen

Lionel Messi vazhdon të shkëlqejë në ligën MLS dhe në ndeshjen kundër New England Revolution vendosi një rekord të ri. Inter Miami fitoi me rezultat të ngushtë 2-1 në transfertë me New England Revolution dhe kjo fitore erdhi e gjitha falë Messit. Messi e kaloi Inter Miamin në epërsi në minutën e 27 dhe në minutën e 38, me një asistim të shkëlqyer nga Sergio Busquets, dyfishoi rezultatit. Me golin e dytë në ndeshje, Messi shkroi historinë e ligës MLS sepse u bë lojtari i parë në historinë e kësaj gare që shënoi dy ose më shumë gola në katër ndeshje radhazi. E tëra çfarë bëri New England Revolution në ndeshje ishte të shënonte një gol ngushëllimi me anë të Carles Gil në minutën e 79. Ylli argjentinas e ka kaluar tashmë rekordin e legjendës braziliane, Pele. Messi tani ka luajtur më shumë ndeshje sesa Pele në historinë e tij në MLS (65 ndeshje për Leo krahasuar me 64 për Pelen). Numrat janë shumë në favor të Messit, i cili ka 54 gola dhe 24 asistime krahasuar me 37 gola dhe 18 asistime të Pelesit.

Fiorentina zyrtarizon transferimin e Dzekos

Fiorentina ka njoftuar zyrtarisht nënshkrimin e qendërsulmuesit veteran, Edin Dzeko, i cili kthehet për një periudhë të tretë në Serinë A në moshën 39-vjeçare pas një periudhe dyvjeçare me Fenerbahçen. Ish-sulmuesi i

Wolfsburgut, Manchester Cityt, Romës dhe Interit i është bashkuar klubit "Viola" si transferim i lirë pas skadimit të marrëveshjes së tij dyvjeçare në Stamboll dhe ka nënshkruar një kontratë njëvjeçare me opSION për 12 muaj shtesë, e cila mund

ta çojë atë deri në moshën 41 vjeç. "ACF Fiorentina njofton se ka fituar të drejtat sportive të futbollistit Edin Dzeko. I lindur në Sarajevë më 17 mars 1986, Dzeko ka nënshkruar një kontratë që do ta lidhë atë me 'Violën' deri më 30 qershor

2026, me një rinovim automatik deri më 30 qershor 2027 në kushte të caktuara", thuhet në deklaratën zyrtare të klubit. Qendërsulmuesi me përvojë, i cili ka 141 ndeshje dhe 68 gola nëndërkombëtarë me Bosnjë-Hercegovinën në emrin e tij,

vjen pas një sezoni në të cilin shënoi 21 gola dhe dha tetë asistime sezonin e kaluar. Ai shënoi 25 gola dhe dha 10 asistime nga 46 paraqitje në të gjitha garat gjatë sezonit të tij të parë me Fenerbahçen në sezonin 2023-2024.



Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas neni 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MPPT- NR 01/2024,
Kryeshefi Egzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh. A. Pejë me datë 11.07.2025, shpall konkurs të
jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Vendi punës : Istog
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të caktuar 3 vite me mundësi vazhdimi
Koeficienti i pagës : 2,4

1. Drejton automjetin, kujdeset për rregullsinë e tij dhe është përgjegjës për ngjasen e sigurtë, duke i respektuar rregullat trafikut rrugor dhe të sigurisë.
2. Kujdeset për higjienën dhe pastërtinë e automjetit, si dhe para çdo ndezje të automjetit kontrollojnë gjithëmbarshtëm çdo pajisje dhe cep të automjetit dhe në momentin që vëren problem mekanik apo elektrik lajmëron kryepunëtorin dhe nëse prishja ka ditë që nuk është rregulluar, lajmëron dhe MO, KE për problemin elektrik apo mekanik.
3. Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga kryepunëtori dhe koordinatori operativ në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve.
4. Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatin për fikjen zjarrit dhe pajisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion.
5. Çdo ndalje për mbledhjen e mbeturinës është i obliguar që ta bëjë sigurtë dhe mundësisht në skajin e rrugës ose jashtë rrugës. Gjatë lëvizjes prapa dhe gjatë marrjes së mbeturinave me shpejtësi të vogël është i detyruar të lëshojë 4 treguesit e drejtimit dhe çdo herë për çdo veprim në trafik rrugor të jetë i sigurtë se ai veprim do të bëhet pa shkakuar incident.
6. Duhet të pajisjet me certifikatë të rregullt shëndetësore për ngasje të automjetit dhe e njëjta të jetë valide.
7. Nuk duhet të konsumojë duhan, alkool, apo narkotikë përgjatë drejtimit të automjetit, si dhe barëra të cilat kanë shenja e trekdëshmit të sigurisë me ngjyrë të kuqe në vend të dukshëm.
8. Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit, Kordinatorit Operativ.
9. Është i obliguar të menaxhoi dhe të mbaj nën kontroll ekipin e punëtorëve fizik.
10. Është i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe PPM (pajisjet personale mbrojtëse).
11. Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit.
12. Për mosrespektimin e pikave të lartcaktuara i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeshefit Ekzektiv.

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetim;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

- Përgatitje profesionale - Shkollim të mesëm, kategori përkatëse (C1-C);
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Vendi punës : Istog
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të caktuar 3 vite me mundësi vazhdimi
Koeficienti i pagës : 2.2

1. Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave;
2. Mbledh mbeturinat dhe bën zbrazen e kontejnerëve dhe mjeteve të tjera për hedhura apo qeseve nga shfrytëzuesit e shërbimeve në sektorin privat dhe shtetëror;
3. Pas zbrajes së kontejnerëve dhe mjeteve tjera, është i obliguar t'i kthej ato në vende të caktuara dhe për to të ketë kujdes;
4. Është përgjegjës për kryerjen e punëve në mënyrë efikase dhe kualitative, për sjellje korrekte me qytetarët-shfrytëzuesit e shërbimeve;
5. Është i obliguar të mbaj uniformën e ndërmarrjes dhe pajisjet e tjera të punës dhe mbrojtjes në punë (PPM);
6. Kryen punë bazuar në kontratën e punës por edhe punë tjera me urdhëresë të shoferit dhe kryepunëtorit;
7. Për mos respektimin e pikave të lartcekura i përgjigjet dritëpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetim;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

- Të ketë njohuri për shkrim dhe lexim përparësi shkollimi fillor;
- Aftësi fizike dhe psikike të dëshmuar;
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë

Vendi punës : Istog
Kohëzgjatja : Me kohë të caktuar 1 vitë me mundësi vazhdimi
Koeficienti i pagës : 1.8

1. Obligohet që në terren të sillët korrekt dhe të ketë të veshur uniformë dhe shenjë identifikimi të ndërmarrjes NPL Ambienti Sh.A.

- CV;
- Certifikatë që kandidati nuk është nën hetim;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Certifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

- Shkolla e mesme (preferohet shkolla e mesme ekonomike);
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Data e për aplikim është nga 11.07.2025 deri me 28.07.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Verëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Doni-Beton” shpk, Piranë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Bazën e Prodhimit të Betonit në Piranë, Prizren.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 22.08.2025 në ora 14:00 në Objektin e administratës të komunës së Prizrenit, në Prizren, do të organizohet debat publik nga Kompania “Doni-Beton” shpk, Piranë, Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcXadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Doni-Beton” shpk, Piranë, Prizren, për Pëlqim Mjedisor, – për Parkun Bazën e Prodhimit të Betonit në Piranë, Prizren.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>
Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnv.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Autosallon & Rent a Car Redoni” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811907065 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Autosallon & Rent a Car Redoni” D.O.O. od Prishtinë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811907065 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Autosallon & Rent a Car Redoni” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811907065 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Rr"Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjobiznesi.com, info@kolegjobiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **30.05.2025**, të Kolegjit “BIZNESI” Prishtinë:

SHPALL KONKURS PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK

I. PROFESORA

- 1. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Ekonomik**,
- 2. **Dy (2)** mësimdhënës në programin – **Juridik**,
- 3. **Dy (2)** mësimdhënës në programin - **Menaxhimi i Emergjencave**,
- 4. **Një (1)** mësimdhënës në programin – **Shkenca Kompjuterike**,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të **Kolegjit Biznesi**.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar (vërtetuar), Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **18.06.2025 deri më 30.06.2025**.

Paraqitja e dokumenteve: Bulevardi Dëshmorët e Kombit" Nr. 5, 10000 Prishtinë, Kosovë ose përmes e-mail: info@kolegjobiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjobiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjobiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Tirona Nagavci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10,11,12 si dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Grsa Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 të lëshuar nga shkolla e mesme e mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Atika Canolli nga Prishtina shpall të pavlefshëm dëftesën e klasës 6-9 të lëshuar nga shkolla fillore “Zenell Hajdini”, Prishtinë.

- Anita Canolli nga Prishtina, shpall të pavlefshëm dëftesën e klasës 6-9 te lëshuar nga shkolla fillore “Zenel Hajdini”, Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishe na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër

të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar/e për Stabilitet Financiar
Grada: P06
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Departamenti: Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Analizave Ekonomike dhe Hulumtimeve
Divizioni: Divizioni i Stabilitetit Financiar
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Stabilitetit Financiar

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Përpunon dhe analizon të dhëna duke përdorur metoda dhe mjete të avancuara statistikore për të identifikuar trende dhe rreziqe që mund të ndikojnë në stabilitetin financiar, duke siguruar saktësinë, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e tyre për marrjen e vendimeve
- Menaxhon dhe administron kornizat e brendshme të vlerësimit të rreziqeve sistematike, përfshirë kornizën e stres-testit makroprudencial,
- Hulumton dhe propozon mjete, korniza dhe mekanizma për analizimin e të dhënave dhe vlerësimin e rreziqeve financiare, si dhe kontribuon në përcaktimin e kërkesave për të dhënat e nevojshme, përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe organizimin e tyre për proceset e hulumtimit;
- Rekomandon dhe kontribuon në çështje të ndryshme me relevancë për fushën e stabilitetit financiar dhe proceset e punës në departament;
- Mbështetë bashkëpunimin e nevojshëm me të gjitha palët relevante përkitazi me çështjet e stabilitetit financiar, përfshirë dhe Komitetin Këshilldhënës të Makroprudencës;
- Përbush detyra tjera në bazë të kërkesës së mbikëqyrësit.

Kualifikimet dhe përvoja e kërkuar:

- Të ketë të kryer fakultetin e ekonomisë dhe financave, matematikës financiare, shkencave kompjuterike ose shkencën e të dhënave (data science); preferohet diploma Master.
- Të ketë së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në sektor financiar ose përvojë në fushën e ekonomisë e që ndërlidhet me përgjegjësitë e funksionit/departamentit
- Kërkohen aftësi të shquara analitike dhe interpretim/analizim të të dhënave;
- Kërkohet të demonstroj aftësi të shquara të komunikimit verbal dhe me shkrim, dhe prezantimit tek mbikëqyrësi dhe palët tjera;
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në ekip; aftësi në menaxhimin e kohës lidhur me kompletimin dhe cilësinë e detyrave të punës; aftësi për të punuar në mënyrë efektive me mbikëqyrësin dhe ekipin; aftësi të punuarit, diskutimit dhe bindjes me palët e jashtme;
- Shkathësi të mira statistikore/ekonometrike dhe njohuri të programeve për përpunimin dhe analizim të të dhënave;
- Aftësi të caktimit të prioriteteve të punës dhe të përbushjes së afateve;
- Njohja e shkëlqyeshme e gjuhës angleze paraqet përparësi.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **28 korrik 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



RASPISAVANJE KONKURSA ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv: Službenik/ca za finansijsku stabilnost
Rang: P06
Trajanje zapošljavanja: Na neodređeni period
Odeljenje: Odeljenje za finansijsku stabilnost i ekonomske i istraživačke analize
Odsek: Odsek za finansijsku stabilnost
Izveštava: Šefu Odseka za finansijsku stabilnost

Rezime dužnosti i odgovornosti:

- Obraduje i analizira podatke koristeći napredne statističke metode i alate kako bi identifikovao trendove i rizike koji mogu uticati na finansijsku stabilnost, osiguravajući njihovu tačnost, održivost i pouzdanost za donošenje odluka
- Upravlja i administrira interne okvire za procenu sistemskih rizika, uključujući okvir makroprudencijalnih stres testova,
- Istražuje i predlaže alate, okvire i mehanizme za analizu podataka i procenu finansijskih rizika, kao i doprinosi određivanju zahteva za potrebnim podacima, uključujući njihovo prikupljanje, obradu i organizaciju za istraživačke procese;
- Preporučuje i doprinosi različitim pitanjima relevantnim za oblast finansijske stabilnosti i radnim procesima u odeljenju;
- Podržava neophodnu saradnju sa svim relevantnim stranama u vezi sa pitanjima finansijske stabilnosti, uključujući i Makroprudencijalni savetodavni odbor;
- Obavlja i druge zadatke na osnovu zahteva nadređenog.

Potrebne kvalifikacije i iskustvo:

- Treba da ima završen ekonomski fakultet i finansija, finansijske matematike, računarstva ili nauke o podacima (eng. data science); master diploma je poželjna.
- Treba da ima najmanje dve (2) godine stručnog iskustva u finansijskom sektoru ili iskustvo u oblasti ekonomije u vezi sa odgovornostima funkcije/odeljenja
- Potrebne su izuzetne analitičke veštine i tumačenja/analiza podataka;
- Treba pokazati izuzetne usmene i pismene komunikacijske veštine i veštine prezentacije nadređenima i drugim stranama;
- Sposobnost efikasnog rada u timu; veštine upravljanja vremenom u vezi sa obavljanjem i kvalitetom radnih zadataka; sposobnost efikasnog rada sa nadređenima i timovima; sposobnost rada, diskusije i ubeđivanja sa spoljnim stranama;
- Dobre statističke/ekonometrijske veštine i poznavanje programa za obradu i analizu podataka;
- Sposobnost određivanja prioriteta rada i poštovanja rokova;
- Odlično znanje engleskog jezika je prednost.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac za prijavu CBK-a;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem se navodi interesovanje i podobnost za ovu poziciju;
- Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde od poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje držane pozicije i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte za zaštitu ličnih podataka);
- Izveštaj Kosovskog penzionog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili poresko uverenje Poreske administracije (PAK) kada se zakonski ne primenjuje izveštaj Trusta;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti priznate /zvanično overena od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje kosovskog državljanstva.

Postupak apliciranja:

- Poslednji rok za apliciranje je **28 juli 2025**.
- Apliciranje se može izvršiti preko mreže (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko Arhive CBK-a. Ostali oblici apliciranja neće biti uzeti u obzir.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti preko zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

